Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY
Nr/Br. 214/19
Data/Datum. 29.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.214/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje : z.Blerim Dina– Kryetar,z.Nuhi Paçarizi- Referues, z.Goran Milenković, - Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga operatoret ekonomik:"Ballkan Petrol"SH.P.K. Ferizaj,kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me vajra për Automjetet" me nr. prokurimit: 214-19-1286-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Policia e Kosovës,më datën 23.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** , pjesërisht si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "Ballkan Petrol"SH.P.K., Ferizaj lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me vajra për Automjetet" me nr. prokurimit: 214-19-1286-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Policia e Kosovës.

II. **OBLIGOHET**,autoriteti kontraktues / Policia e Kosovës / të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së, dhe të lejoj sa me shumë konkurrues për te marr pjesë në aktivitetin e prokurimit në fjalë duke i dhëne mundësi te barabartë ofertuesve më oferta më cilësore, lidhur me aktivitetin të prokurimit "Furnizim me vajra për Automjetet" me nr. prokurimit: 214-19-1286-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - Policia e Kosovës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Ballkan Petrol"SH.P.K., Ferizaj aprovohet pjesërisht si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë: Lloji i procedurës së aplikuar: Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: Kontratë publike -furnizim/ vlerë e madhe
Vlera e parashikuar e kontratës 240,000.00€ ;
Kriteri për dhënie të kontratës: tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët; Afati i fundit për dorëzim të ofertave: 27.05.2019;Data e hapjes së ofertave; Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave; Data e njoftimit me letrën standarde; Data e kërkesës për rishqyrtim 09.05.2018;Data e vendimit nga AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim: 13.05.2019;

Operatori ekonomik ankues: 'Balkan Petrol" –Ferizaj , si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 15.05.2019, me nr. 214/19, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me vajra për Automjetet" me nr. prokurimit: 214-19-1286-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Policia e Kosovës, duke pretenduar në shkelje të këtyre dispozitave te LPP-së:

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 28 i LPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së,me datë: 29.05.2019,ka autorizuarekspertin shqyrtues dhe teknik tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik në raportin e datës:10.06.2019,kan konstatuar:

Lidhur me pretendimin ankimorë të OE ankues për specifikat teknike për këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues teknik sqaron se :

Dosja e tenderit e bërë nga AK është në përputhje me të gjitha kërkesat teknike të vajrave të motorit, me performancën e miratuar nga prodhues të ndryshëm.

Specifikimi përfaqëson ndërfaqen/interfejsin midis karakteristikave fizike dhe kimike të naftës dhe kërkesave të prodhuesit të automjetit. As prodhuesit e automjeteve, as prodhuesit e naftës nuk japin një listë të të gjitha karakteristikave në gazetat e tyre apo në doracakët e përdorimit. Prodhuesit kombinojnë grupe të parametrave të pritura me rezultatet e testimit, ndërsa prodhuesit e naftës në bazë të kërkesave provojnë produktin, që produkti i tyre është i përshtatshëm për përdorim. Mund të themi se lista e specifikimeve është një listë praktike e kodeve në bazë të të cilave ne përdorim vajin e përshtatshëm për mjetin përkatës, të cilin AK në dosjen e tenderit e ka respektuar plotësisht.

Duke i marrë parasysh të gjitha më lartë të cekura, i propozojmë OSHP- së që ankesën e OE "BALKAN PETROL" shpk Ferizaj të refuzojë si të pabazuar, dhe që aktiviteti i prokurimit të vazhdohet në përputhje me LPP- n.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet e pabzuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjjet në pretendimet ankimore), ndërsa rekomandon që AK të vazhdoj me procedura të mëtutjeshme për këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës, brenda afatit ligjor nuk ka kthyer përgjigje për panelin shqyrtues për te njoftuar se pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues teknik.

Operatori Ekonomik–"Ballkan Petrol"SH.P.K., Ferizaj me datë: 12.07.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës;23.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi,përfaqësuesit e OE ankuese, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, ekspertishqyrtues-teknik ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimit për anulim, ankesat e operatoreve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesii OE-së ankues z. Haliti deklaroj: Ne kemi marr mendimin e ekspertit dhe nuk pajtohemi me te ne justifikimin qe ka dhen ne aktin përcjellës te datës: 10.06.2019, është i pa qartë dhe për neve si OE edhe gjithashtu si prodhues i vajrave nëse ka mundësi ne ketë seance eksperti shqyrtues qe gjatë seancës ta elaburon me mire propozimin qe ka kërkuar te refuzohet ankesa jone. Nëse merret për bazë vetëm kërkesa e Autoriteti Kontraktues te specifikacioni ku citohet: çdo spec i kërkuar ne DT duhet te përmbush me pike e me prese ne certifikatë dhe etikete ne mendojmë se kjo ne bazë te specifikacione te dhen nga Autoriteti Kontraktues kjo edhe 10-15 vite nuk do te zgjidhet. Ne kemi vërejtje se për te njëjtin AP pasi qe ky ka filluar nga viti 2018 ne disa here radhazi ne kemi ndalur me te lire ne ketë AP me një tender shume voluminoz qe ka qenë para kësaj here Autoriteti Kontraktues policia e Kosovës na ka eliminuar vetëm për një detal qe mendojmë ku thotë se OE ka ofruar vaj E7 E9 e i mungon specifikacioni E1 pse nuk shkruan ne ambalazhe E1 mund ta marr edhe një shembull: nëse kërkohet dikund një vend te punës ta prezantoj Diplomën me Universitet dhe nëse nuk e ka prezantuar edhe diplomën e shkollës fillore duhet me diskualifiku. Krejt ketë AP qe janë duke e zvarritur ne asgjë me tepër duke e kuptuar rendësin e Autoriteti Kontraktues qe ka nevoje për vajra për antifriz ne asnjë here nuk kemi dashtë qe te jemi ne shkaktar qe ky autoritet te mos ketë furnizim, pas shkresave tona qe ju kemi dërguar AK nuk ka pas vullnet qe ti merr për bazë kërkesat e OE-ve. Rasti tjetër ne kemi vërejtur gjatë gjithë këtyre ekziston subjektivizëm parasysh se prapa jemi eliminuar si OE Ballkan Petrol me një letër standarde për eliminim me 15.04.2019 ku thotë ku edhe ne tenderin e njëjte janë kërkuar specifika te njëjta ku për një produkt kërkohet AC-ja A1/B1 dhe A5/B5 ku ne si OE eliminohemi kurse për çudi e shpallin te përgjegjshëm 2 OE ku njeri nga ta ku kërkohet AC-ja A1/B1 dhe A5/B5 ne mostrat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues mungon A1 B1 por AK arsyetohet po citoj" mostrat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontrate janë konform specifikave dhe parametrave qe ju i keni cekur qe OE i rekomanduar për kontrate nuk i plotëson dhe thotë nuk qëndron" pasi ne DT është kërkuar produkti te këtë AC A1 B1 A5/B5 mostrat e dorëzuara nga OE përmban parametrin AC A5 dhe B5 ku mungon A1 dhe B1 dhe thonë është konform kërkesës ne DT ne lidhje me përformancën e vajit, atëherë shtrohet pyetja Qysh Autoriteti Kontraktues mund te kërkoj me spec. Me pika me presje duhet OE te përmbush ku ne jemi eliminuar për raste te tjera kurse OE tjetër e shpall te përgjegjshëm. Edhe ne ankesën tone te fundit asgjë me tepër nuk kemi kërkuar ne se ne specefikime teknik te përpiluar nga Autoriteti Kontraktues qe te pranohen vetëm specifikat me te larta te pranohen e mos te jen obligative edhe specifikat me te ulëta" AC- A3/B4 , A3/B3 ne kemi ofruar specifikacionin me te larte A3/B4 dhe këta thonë pse nuk ekziston ne certifikate A3/B4 për këtë ju kemi eliminuar". Asnjë OE edhe eksperti këtë e ka pasur ne dëshmi ku janë standardet ku thotë A3/B4 e mbulon A3/B3. E kemi rastin tjetër kërkohet PSA B712294/2300/ Spec me i larte B712300 ku ne pyetjet tona sqaruese kemi kërkuar se a pranohet spec. Me

i lart i ofruar dhe Autoriteti Kontraktues na është përgjigjur se jo nuk pranohet, duke i marr për bazë ne një AP do te ofertojmë dhe do te eliminohemi.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Baftija deklaroj: Sa i përket ankesës OE lidhur me pyetjet qe kanë bërë OE përgjigjet qe i kthejmë vlejnë për te gjithë OE-te ne vlerësojmë ne mënyrë te barabartë pa diskriminim, kurse sa i përket ankesës se OE pyetjet qe i bëjnë ne nuk e dimë cili OE i bën por përgjigjet i kthejmë për te gjithë. Sa i përket specifikat ato kanë qenë kompatibile me automjetet qe i posedojmë.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Halili deklaroj: Pretendimi kryesor dhe i vetëm ka te bëjë me spec teknike te vajit për te cilin pretendim eksperti teknik ka jepe mendimin dhe vlerësimin e tije dhe mbi bazën e përgjigjën e ekspertit teknik ku ka konstatuar se specefikime teknike janë ne rregull kemi rekomanduar te refuzohet ankesa.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga Paneli shqyrtues qe te detyroj AK qe mos te kufizoj me specifika me te ulëta OE dhe prodhuesit e vajrave pasi qe prodhuesit e vajrave kanë avancuar dhe nuk e shohim specifikat e vjetra sepse vajrat tani janë me cilësorë, është e palogjikshme nëse vaji E7 E9 ne spec. E eliminohesh qe nuk e ke ofruar E1 apo E2,

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: kërkojmë te refuzohet si e pabazuar ankesa e OE dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues-teknik , deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor,sqaron se pretendimet ankimore për aktivitetin e prokurimit në fjalë kanë të bëjnë me kriteret e vendosura në dosjen e tenderit.

Lidhur me pretendimin ankimorë të OE ankues për specifikat teknike për këtë aktivitet të prokurimit, Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues nuk duhet te eliminoj ofertuesit nëse ata ofrojnë produkte më cilësore e që produktet në fjalë, që janë në pajtim me specifikat teknike të kërkuara nga AK-ja.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se autoriteti kontraktues duhet te përpiloj specifikacione teknike në atë mënyrë që ato te jen në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe te drejtuara drejt sigurimit te qasjes sa te mire për te gjithë operatoret e interesuar ekonomik, konstaton se në rastin konkrete AK-ja duhet ti ju jep mundësi te barabartë ofertuesve te cilët kanë produkte me cilësore në pajtim me specifikacionet teknike te kërkuara nga AK-ja, Obligohet AK qe ne te ardhmen, gjate vlerësimit te ofertave te Operatoreve Ekonomik (ku ne rastin konkret OE ka ofruar prova se është eliminuar nga vet AK-PK ku ne këtë rast nëse një produkt i cilësisë me te larte, kur vet AK e pranon ne sqarime se lejohen edhe produkte te cilësisë me te larte kurse gjate vlerësimit te ofertës ta eliminoj nëse ne tiketën e tije nuk e përmban shenja te produkteve siç janë kërkuar ne dosje) te mos e diskualifikoj nga procedura e prokurimit asnjë Operator Ekonomik, nëse ne dosje te tenderit është e specifikuar apo edhe gjate fazës se sqarimit te tenderëve, se ju lejohet te ofertojnë me produkte me cilësore .

Paneli shqyrtues konstaton se duke i marrë parasysh të gjitha sqarimet e dhanë si me lart konstatojmë se AK për aktivitetin e prokurimit në fjale duhet te veproj në pajtim me nenin 53.7 te LPP-së, duke i përshtatur kërkesat e FDT-së me nevojat dhe qëllimin e aktivitetit te prokurimit që po prokuron duke mos diskriminuar apo favorizuar asnjë ofertues, dhe duke prokuruar (blerë) produkte më cilësore për nevojat e veta.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Policia e Kosovës

1x1 OE "Ballkan Petrol"SH.P.K, Ferizaj

1x1 Arkives së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.